

Gucati për protestën në
Tiranë: Kemi marrë
mbështetje të madhe, do
të protestojmë kundër
padrejtësisë në Hagë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSH HYN NË 'MATEMATIKAT' E KURTIT PËR FORMIMIN E QEVERISË?



Analistët vlerësojnë se
Vetëvendosja mund të arrijë
marrëveshje me LDK-në për

formimin e qeverisë duke
parë rezultatet e ngushta në
zgjedhjet lokale dhe

interesimin e përbashkët
për t'i shmangur zgjedhjet e
reja

**KURTI THOTË SE
ENDE S'KA NISUR
DISKUTIME ME
PARTITË PËR
FORMIMIN E
EKZEKUTIVIT**

F.7



**BE-JA PRET
CERTIFIKIM TË
SHPEJTË TË
REZULTATEVE
DHE TRANZICION
TË RREGULLT
TË PUSHTETIT**

F.7



**TARIFAT E TRUMPIT PËR DRURIN
DHE MOBILIET HYJNË NË FUQI,
RREZIKOHEN EDHE TREGTARËT E
KOSOVËS**

F.8

**TRE EKONOMISTË FITOJNË
NOBELIN MBI NDIQIMIN E
TEKNOLOGJISË PËR RRIJTEN
EKONOMIKE**

F.8

SPORT



**KOSOVA SHËNON FITORE
HISTORIKE NË SUEDI**

F.11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PENGJET IZRAELITE LIROHEN, TRUMPI DHE LIDERËT BOTËRORË NËN SHKRUAN PLANIN PËR PAQE NË GAZË

JERUSALEM, 14 TETOR - Njëzet pengje të gjalla që mbaheshin nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - u liruan, në bazë të një plani 20-pikësh të presidentit amerikan Donald Trump që mundësoi edhe armëpushimin në Gazë. Pamje emocionuese u panë gjatë ribashkimit të pengjeve izraelite me familjarët e tyre, por edhe të palestinezëve të burgosur që u takuan me familjarët e tyre pas lirit. Izraeli tha se ka liruar afër 2 000 palestinezë nga burgjet e tij. Përveç pengjeve të gjalla, Hamasi ka dorëzuar te Kryqi i Kuq, i cili

më pas i ka transferuar Izraelit mbetjet mortore të katër pengjeve të vdekur. Trumpi qëndroi një ditë më parë në Izrael për të përcjellë nga afër këtë ngjarje. Gjatë qëndrimit atje, ai iu drejtua Parlamentit izraelit. Gjatë fjalimit ai tha se të gjithë janë dëshmitarë të një agimi historik të një Lindjeje të Mesme të re. Tani do të jetë “koha e artë për Izraelin, koha e artë për gjithë rajonin”, u shpreh Trump. Më pas Trumpi u nis drejt Egjiptit, ku së bashku me udhëheqësin e këtij shteti, udhëhoqi një samit të paqes në

Lindjen e Mesme. Gjatë samitit, Trumpi dhe udhëheqësit e Egjiptit, Katarit dhe Turqisë nënshkruan planin për paqe në Gazë. Udhëheqësi amerikan tha se lufta ka marrë fund në Gazë dhe se më në fund lutjet e miliona personave u dëgjuan. Ai tha se në mënyrë që Gaza të rindërtohet, duhet që fillimisht të çarmatoset. Pas qëndrimit për disa orë në Egjipt, ku nënshkroi planin për paqe në Gazë së bashku me Egjiptin, Katarin dhe Turqinë, presidenti amerikan, Donald Trump, është larguar nga Sharm el-Sheik.



VON DER LEYEN: MALI I ZI ËSHTË AFËR ANËTARËSIMIT NË BE

PODGORICË, 14 TETOR - “Synimi që Mali i Zi të anëtarësohet në Bashkimin Evropian është me të vërtetë pranë arritjes”, deklaroi presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, teksa hapi konferencën e parë për investime Mali i Zi - BE në vendpushimin turistik Lushtica pranë Tivatit. Von der Leyen tha se janë bërë hapa pozitivë dhe se ka ardhur koha të investohet në Mal të Zi. “Ju jeni shumë ambiciozë dhe kjo na pëlqen”, tha shefja e Komisionit Evropian. Siç theksoi zyrtarja evropiane, duhet të përshpejtohen reformat në fushën e sundimit të ligjit, të ketë transparencë në prokurimet publike dhe në këtë mënyrë të dërgohet një sinjal se Mali i Zi është një vend i besueshëm për zhvillimin e biznesit. Kryeministri i Malit të Zi, Millojko Spajiq, vlerësoi se BE-ja është partnerja më e rëndësishme strategjike dhe investuesja më e madhe në Mal të Zi. Ai njoftoi për një cikël investimesh që e presin Malin e Zi në vitet e ardhshme. “Një cikël që do t’i tërheqë mbi tre miliardë euro. Ky është

mesazhi kryesor që nga sot: Mali i Zi është i hapur për biznes dhe se tani është koha për të investuar”. Spajiq përsëriti qëndrimin se Mali i Zi është në prag të anëtarësimit në BE. “Deri në fund të vitit 2026 do t’i mbyllim të gjithë kapitujt e negociatave në mënyrë që të bëhemi anëtar i bllokut deri në fund të vitit 2028”, tha Spajiq. Ai theksoi, gjithashtu, se kjo është një mundësi për BE-në që të tregojë se politika e zgjerimit “është gjallë”. Në konferencë, e cila iu kushtua zhvillimit të qëndrueshëm, do të paraqiten katër projekte të investimeve evropiane në ekonominë e Malit të Zi dhe do të nënshkruhen dhjetë memorandumë mirëkuptimi në fusha të ndryshme.

Brukseli vlerëson politikën e jashtme të Podgoricës

Në konferencën për medie pas hapjes së konferencës, Von der Leyen theksoi se Bashkimi Evropian e vlerëson shumë përafrimin e Malit të Zi me



politikën e jashtme dhe të sigurisë së Brukselit, veçanërisht sa iu përket raporteve me Rusinë. “Agresioni rus kundër Ukrainës e ka riformësuar kontinentin tonë. Çdo komb evropian duhet ta zgjedhë vendin dhe anën e tij dhe Mali i Zi e ka bërë tashmë këtë zgjedhje shumë qartë. Ju jeni plotësisht të harmonizuar me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së. E vlerësojmë thellësisht vendimin për të dërguar ushtarë malazezë për ta mbështetur misionin tonë të trajnimit për Ukrainën”, tha von der Leyen. Ajo e inkurajoi Malin e Zi që t’i

shfrytëzojë 380 milionë eurot nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe, po ashtu, njoftoi se vitin e ardhshëm do të hiqet roaming-u mes Malit të Zi dhe BE-së. “Mali i Zi tani do t’i marrë 8 milionë euro pasi i ka përmbushur kushtet, por duhet të vazhdojë me reformat për të arritur të kushtet për shfrytëzimin e të gjithë fondit prej 380 milionësh që është paraparë për Malin e Zi”, tha zyrtarja e lartë evropiane.

Raport i ri i Progresit i BE-së, më 4 nëntor

Kryeministri i Malit të Zi,

Millojko Spajiq, tha se raporti i Komisionit Evropian për progresin e Malit të Zi pritet të publikohet më 4 nëntor. “Është një pasqyrë reale e gjendjes. Do t’i reflektojë rezultatet e mëdha që janë arritur në periudhën e kaluar, por do t’i tregojë edhe sfidat dhe detyrat që duhet të përmbushim në periudhën e ardhshme”. Në atë raport do të vlerësohet përmbushja e kriterëve për anëtarësim, me fokus në fushën e sundimit të ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit, në fushën e demokracisë dhe përafrimit me ligjet e BE-së. Që nga raporti i vitit të kaluar, Mali i Zi i ka mbyllur katër kapituj negociues, i fundit në qershor, që ka të bëjë me prokurimin publik. Më herët, në dhjetor 2024, mbylli tre - kapitullin 7 (E drejta dhe pronësia intelektuale), 10 (Shoqëria informatike dhe mediet) dhe 20 (Ndërmarrësia dhe politika industriale). Mali i Zi i ka nisur negociatat e anëtarësimit me BE-në para 13 vjetësh dhe deri më tani i ka mbyllur shtatë kapituj negociues nga gjithsej 33.

Vdes edhe një person si pasojë e zjarrit në Koçan

KOÇAN, 14 TETOR - Numri i viktimave nga zjarri që përfshiu një klub nate në Maqedoninë e Veriut është rritur në 63, pasi një muzikant vdiq nga plagët e marra pothuajse shtatë muaj pas incidentit, tha prokuroria maqedonase më 14 tetor. Vladimir Bllazhev-Pancho,

këngëtari 46-vjeçar i bendit DNK, vdiq në Shkup të martën, pasi ishte hospitalizuar për shkak të lëndimeve serioze, kanë konfirmuar prokurorët. Më 16 mars, gjatë një koncerti në klubin Pulse në Koçan, shpërtheu zjarr në klubin e stërmbushur me njerëz, duke

lënë të vdekur dhjetëra persona. Si pasojë e zjarrit u plagosën pothuajse edhe 200 persona të tjerë. Tetë muzikantë nga ky bend ishin në mesin e viktimave nga zjarri. Tragjedia në Koçan ndodhi gjatë një koncerti nga grupi muzikor DNK, kur shkëndijat

nga mjetet piroteknike ia vunë zjarrin tavanit të diskotekës, duke bërë që flakët të përhapeshin me shpejtësi dhe paniku dhe dalja e ngushtë nga ndërtesa të shkaktonin rrëmujë të madhe. Prokurorët kanë thënë se klubi pothuajse nuk përmbushte asnjë standard të sigurisë.



MAQEDONCI TAKON DREJTORIN E AGJENCISË SË DEPARTAMENTIT TË LUFTËS TË SHBA-së, FLASIN PËR PAJISJE DHE SISTEM TË ARMATIMIT



radhës si dhe për ndihmën që Kosova i ka ofruar Ukrainës. Drejtori Miller e përgëzoi Kosovën për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Ndërveprueshmëri dhe Siguri në Komunikim (CISMOA), duke e cilësuar atë si një hap të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit dypalësh.

Maqedonci nderohet në Sallën e Famës të Kolegjit të Luftës të Ushtrisë së ShBA-së

Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, është nderuar me përfshirjen në Sallën e Famës (Hall of Fame) të Kolegjit të Luftës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (US Army War College). Ky është një vlerësim i rrallë që u jepet ish-studentëve ndërkombëtarë për kontributin e tyre të shquar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në vijim keni postimin e plotë të ministrit Maqedonci: “Është nder jetësor për mua vlerësimi duke me vendosur në Sallën e Famës (Hall of Fame) të Kolegjit të Luftës

të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (US Army War College) ku i pranishëm ishte dhe Gjenerali Randy A. George Shef i Shtabit të Ushtrisë së ShBA-ve. Këtë vlerësim nuk e llogaris vetëm si një arritje personale, por edhe një pasqyrim i përkushtimit, profesionalizmit dhe përpjekjes së përbashkët të të gjithë atyre me të cilët kam pasur fatin dhe mundësinë të shërbej gjatë karrierës sime. Shpreh mirënjohjen time të sinqertë ndaj Kolegjit të Luftës të Ushtrisë së ShBA-së për këtë nderim dhe mundësinë që para

disa viteve më ofruan për të përfunduar studimet në këtë akademi duke ndikuar kështu në formimin tim profesional dhe personal. Gjithashtu shpreh mirënjohjen time të pafund ndaj kolegëve, mentorëve dhe mbi të gjitha ndaj familjes sime për mbështetjen e tyre të vazhdueshme. Ky nderim më forcon më tej bindjen time në fuqinë e shërbimit, udhëheqjes dhe mësimin të përgjeshëm - vlera që kapërcejnë kufijtë dhe bashkojnë të gjithë ata që i shërbejnë vendit dhe komunitetit të tyre”.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 TETOR - Në margjina të panairit “AUSA 2025”, ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, është takuar me drejtorin e Agjencisë për Bashkëpunim në Mbrojtje dhe Siguri në kuadër të Departamentit të Luftës të ShBA-së, Michael F. Miller. Në takim ishin të pranishëm edhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, atashëu i mbrojtjes i Republikës së Kosovës në ShBA, Sylejman Cakaj, si dhe drejtori i

Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Ahmet Ajeti. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e mbrojtjes, me theks të veçantë në prokurimin e pajisjeve dhe sistemeve të armatimit, i cili për Forcën e Sigurisë së Kosovës është realizuar kryesisht përmes mekanizmit FMS (Foreign Military Sales), duke mundësuar blerje shtet me shtet me ShBA-në, me kosto më të ulët dhe cilësi më të lartë të produkteve të prokuruar. U diskutua edhe për prokurimet e

PROKURORIA NIS GRUMBULLIMIN E INFORMACIONEVE PËR VJEDHJE TË VOTAVE NË MITROVICË



PRISHTINË, 14 TETOR - Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka nisur grumbullimin e informacioneve për vjedhje të votave në Mitrovicë. Lajmin për “Albanian Post” e ka konfirmuar zëdhënësi i prokurorisë, Valon Preteni. “Janë duke u grumbulluar informata lidhur me pretendimet për keqpërdorim të votave në këtë lokacion. Kaq mund të themi në këtë fazë”, ka deklaruar Preteni. Gjatë procesit zgjedhor në Mitrovicë janë shfaqur disa shqetësime nga njohës të çështjeve politike për shkak se, pas publikimit të exit-poll-eve që parashikonin një fitore të qartë të

kandidatit të PDK-së, Arian Tahiri, ka pasur reagime të cilët kanë kërkuar hetime për ta verifikuar saktësinë në procesin zgjedhor në këtë komunë. Numërimi në Komunën e Mitrovicës ka përfunduar të hënën. Sipas rezultateve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Arian Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka arritur të sigurojë 47.89 % të votave, ose 15 368 vota. Faton Peci nga Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 47.80 % të votave, ose 15 340 vota, duke lënë pas Gëzim Plakollin nga

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 3.57 %, ose 1 146 vota. Ndërkaq Qazim Nimani nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka marrë 0.74 % të votave, ose 237 vota. Dalja në zgjedhjet lokale të 12 tetorit, sipas KQZ-së, ka qenë 39 për qind. Sipas këtyre të dhënave në këto zgjedhje, të drejtë vote kanë pasur 2 069 098 qytetarë. Rreth 44 000 prej tyre kanë mundur të votojnë me postë nga jashtë vendit në periudhën 17 shtator - 11 tetor. Institucionet e sigurisë kanë njoftuar se procesi është zhvilluar i qetë, pa ndonjë incident të madh.

Osmani takon Perestrellon, thotë se anëtarësimi i Kosovës në NATO mbetet prioritet i politikës së jashtme

PRISHTINË, 14 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar presidentin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Marcos Perestrello, të cilin e ka falënderuar për nominimin për Çmimin për ‘Gratë, Paqen dhe Sigurinë’ si dhe vendimin e Asamblesë Parlamentare që t’ia japë këtë vlerësim, i cili,

njëkohësisht, është edhe vlerësim për të gjitha gratë e Kosovës. “Diskutuam për rolin në rritje të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, pas vendimit për avancimin e statusit tonë në anëtare të asociuar - një hap i rëndësishëm përpara në rrugëtimin tonë euroatlantik. Rikonfirmova se Kosova do

të shfrytëzojë plotësisht këtë mundësi si pjesë e aspiratës sonë më të gjerë për anëtarësim në NATO, që mbetet njëkohësisht prioritet i politikës sonë të jashtme dhe çështje e rëndësishme së veçantë për sigurinë kombëtare”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.





KUSH HYN NË “MATEMATIKAT” E KURTIT PËR FORMIMIN E QEVERISË?

Analistët vlerësojnë se Vetëvendosja mund të arrijë marrëveshje me LDK-në për formimin e qeverisë, duke parë rezultatet e ngushta në zgjedhjet lokale dhe interesimin e përbashkët për t'i shmangur zgjedhjet e reja

Prishtinë, 14 tetor - Albin Kurti ka afat deri më 26 tetor për të siguruar 61 vota në Kuvend dhe për ta propozuar përbërjen e qeverisë së re. Analistët vlerësojnë se Vetëvendosja mund të arrijë marrëveshje me LDK-në për formimin e qeverisë duke parë rezultatet e ngushta në zgjedhjet lokale dhe interesimin e përbashkët për t'i shmangur zgjedhjet e reja. Posti i presidentit, që mbetet vakant në prill kur i skadon mandati Vjosa Osmanit, shihet si pjesë e kalkulimeve politike. Udhëheqësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka më pak se dy javë kohë për t'i paraqitur Kuvendit përbërjen e qeverisë së re për miratim. Ndërsa afati përfundon më 26 tetor, analistët vërejnë një atmosferë më të qetë dhe më të favorshme për negociata ndërpartiake pas përfundimit të raundit të parë të zgjedhjeve lokale më 12 tetor. Sipas tyre, këto zgjedhje janë ndërlikuar edhe me procesin e gjatë të konstituimit të Kuvendit i cili është përmbyllur vetëm në fund të javës së kaluar, pas disa muajsh bllokadë. Albert Krasniqi nga organizata “Demokraci Plus” thotë se

partitë kanë pritur përfundimin e zgjedhjeve lokale për ta shmangur ndikimin që mund të sillte formimi i një koalicioni qendror në garat komunale. “Aleancat që mund të bëhen, mund ta rritin irritimin te partitë e tjera që të mos i përkrahin. E në komuna të caktuara, ku gara është shumë e ngushtë, kjo është shumë qenësore”, thotë Krasniqi për “Radion Evropa e Lirë”. Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit doli fituese në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Një ditë pas konstituimit të Kuvendit, më 10 tetor, presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e mandatoi Kurtin për formimin e qeverisë së re. Megjithatë, me vetëm 48 ulëse të fituara, Vetëvendosjes i nevojiten edhe 13 për ta siguruar shumicën prej 61 deputetësh në Kuvendin me 120 vende. Kurti paralajmëroi se gjatë kësaj jave do t'i nisë bisedimet për krijimin e qeverisë, por nuk dha hollësi me cilat parti do të zhvillohen këto diskutime. Pak ditë më parë bashkëpartiajka e tij, Albulena Haxhiu, përjashtoi mundësinë e një koalicioni me Partinë

Demokratike të Kosovës dhe me Listën Serbe - partinë më të madhe të komunitetit serb në Kosovë - por e la të hapur mundësinë për bisedime me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Një kombinim i mundshëm mes këtyre dy partive, sidomos në dritën e rezultateve të zgjedhjeve lokale, shihet si skenar real edhe nga analisti Krasniqi. “Nëse LDK-ja dhe Vetëvendosja arrijnë marrëveshje për koalicion në nivel qendror, ato mund të koordinohen që LDK-ja ta ketë një garë më të lehtë në Prishtinë dhe Vetëvendosja të mos i ndez të gjithë motorët për ta fituar këtë garë”, thotë ai. Rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve treguan një garë të ngushtë në Prishtinë mes kandidatit të LDK-së, Përparim Rama, dhe atij të Vetëvendosjes, Hajrulla Çeko, me një diferencë prej rreth 700 votash. Për pasojë, të dy kandidatët do të përballen kokë më kokë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale më 9 nëntor. Raund të dytë votimesh do të ketë edhe në 16 komuna të tjera. Në disa prej tyre kandidati i Vetëvendosjes garon me kandidatin e LDK-së e në disa me atë të PDK-së. Afrim Hoti, profesor në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, pret që këto dy parti të jenë “pjesë e matematikave”

të Vetëvendosjes për ta formuar qeverinë dhe jo partitë e tjera, si AAK-ja dhe Nisma, “për shkak të fuqisë së vogël politike”. “Kjo është një rrugë njëdrejtimëshe, për aq kohë sa duan të ecin përpara drejt formimit të institucioneve. Alternativë do të ishte shkuarja në zgjedhje të jashtëzakonshme, gjë për të cilën nuk mendoj se ekziston konsensus apo vullnet mes subjekteve kryesore politike”, thotë Hoti për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shpjegon se ky qëndrim bazohet edhe te rezultatet e zgjedhjeve lokale, të cilat, sipas tij, treguan se “harta politike” nuk do të ndryshonte ndjeshëm as pas zgjedhjeve të reja parlamentare. Një tjetër faktor përcaktues për formimin e qeverisë, sipas analistëve, është edhe posti i presidentit. Mandati i presidentes Vjosa Osmani përfundon në prill të vitit të ardhshëm dhe, sipas profesorit Afrim Hoti, ajo nuk gëzon më të njëjtën mbështetje që kishte në vitin 2021, kur lista e saj Guxo u bashkua me Vetëvendosjen e Albin Kurtit. “Ndaj, rrethanat e reja sjellin në tryezën e bisedimeve edhe postin e presidentit”, thotë ai. Presidenti i Kosovës zgjidhet nga Kuvendi me dy të tretat e 120 votave. Nëse kandidati nuk i siguron ato në dy raundet e para, në të tretin mjafton shumica e

thjeshtë. Nëse as atëherë nuk zgjidhet, Kuvendi shpërndahet dhe mbahen zgjedhje të reja brenda 45 ditësh. “Kështu që, mendoj se më shumë bëhet fjalë për kalkulime të partive politike të cilat bazohen në frikën e tyre për jetëgjatësinë e qeverisë sesa për dallime të mëdha përmbajtësore që ato i kanë për të formuar një koalicion qeverisës”, thotë Krasniqi. Kurti deklaroi të martën se ende nuk ka nisur bisedimet me partitë për formimin e Qeverisë së re. Nëse ai nuk arrin t'i sigurojë 61 vota deri më 26 tetor, presidentja Osmani, brenda 10 ditësh, duhet t'i ftojë partitë në konsultim dhe, sipas diskrecionit të saj, t'ia japë mandatin një kandidati tjetër që dëshmon se ka shumicën parlamentare. PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma kanë dërguar sinjale të ndryshme muajt e fundit për mundësinë e bashkëpunimit me Vetëvendosjen, e cila ka shprehur gatishmëri të bashkëpunojë edhe me pakicat joserbe për formimin e qeverisë. “Radio Evropa e Lirë” bëri përpjekje të kontaktojë disa zyrtarë të lartë të LDK-së - partisë së përmendur nga Vetëvendosja si partnere e mundshme - por nuk ishin të qasshëm. Kurti tha se nuk do ta presë afatin e fundit nëse bisedimet me ndonjërin nga partitë rezultojnë të suksesshme.

KURTI: ENDE S'KA NISUR DISKUTIME ME PARTITË PËR FORMIMIN E EKZEKUTIVIT



Prishtinë, 14 tetor - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën se ende nuk i ka nisur diskutimet me partitë e tjera lidhur me formimin e Qeverisë së re të Kosovës.

Më 10 tetor, Kurti, udhëheqës i Lëvizjes Vetëvendosje, është mandatuar nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, për formimin e ekzekutivit të ri. “Tepër shumë punë këto ditë, analiza e rezultateve nga qendrat. Na duhet t’i shohim kontributet që i kanë pasur fushatat nëpër komuna me rezultatin që kemi arritur, në mënyrë që sa më shpejt ta fillojmë fushatën për balotazhe. Andaj dje dhe sot nuk kam arritur ende që t’i zhvillojmë ato komunikime. Por, po e bëjmë një plan edhe

për këtë gjë. I kemi më shumë se dhjetë ditë”, ka thënë Kurti për mediet kur është pyetur nëse ka nisur diskutime me subjektet politike për qeverisjen qendrore.

Një ditë më parë Kurti paralajmëroi se diskutimet për Qeverinë e re të Kosovës do t’i nisë këtë javë.

Partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, por jo mjaftueshëm për ta formuar vetë udhëheqjen e re.

Kurti ka afat që deri më 26 tetor të paraqesë para Kuvendit ekzekutivin e ri. Për zgjedhjen e tij kërkohen 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh. “Kosovës i duhet edhe një mandat i qeverisë sonë, i duhet një mandat i ri i qeverisë sonë.

Neve na duhet një mandat i ri në përputhje me rezultatin e 9 shkurtit sivjet”, ka deklaruar Kurti në një konferencë për medie më 13 tetor. Ai nuk dëshoi të japë hollësi se me cilat parti mund të diskutojë për ndonjë koalicion të mundshëm.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka deklaruar ditë më parë se LV-ja mund të diskutojë me Lidhjen Demokratike të Kosovës për ndonjë koalicion të mundshëm, pasi Nisma Socialdemokrate nuk ka qenë e interesuar të përfshihet në qeverisje. Ajo e ka përjashtuar ndonjë koalicion të mundshëm me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit.

Njohësit e zhvillimeve politike kanë theksuar se gara e partive politike për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale - që do të mbahet më 9 nëntor - mund t’i ndikojë negociatat për formimin e ekzekutivit të ri.

Nëse LV-ja nuk arrin ta sigurojë mbështetjen e 61 deputetëve për kabinetin e ri deri më 26 tetor, atëherë presidentja Osmani është e obliguar që brenda 10 ditëve t’i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë.

Edhe mandatarin e ardhshëm duhet t’i ketë 15 ditë kohë që t’ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Nëse qeveria nuk formohet as

pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

Analisti Avni Arifi ka vlerësuar që Vetëvendosje si partia e parë e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit nuk do të mund ta formojë qeverinë e re. Ai ka thënë se LV-ja nuk i ka numrat e nevojshëm. “Sipas të gjitha gjasave jo, sepse nuk i ka votat. Që nga 9 shkurti është abuzuar me deklaratën ‘i kam votat’. Kur vinte puna për të votuar, i dilnin vetëm 58 deputetë. Tash i ka dy opsione: nëse mund t’i bindë Duda Baljen dhe Adem Hoxhën dhe ta korruptojë ndonjë deputet nga partitë opozitare”, ka thënë Arifi në emisionin “Ora 7” të “Klan Kosovës”.

GUCA TI PËR PROTESTËN NË TIRANË: KEMI MARRË MBËSHTETJE TË MADHE, DO TË PROTESTOJMË KUNDËR PADREJTËSISË NË HAGË

PRISHTINË, 14 TETOR - Mbi 60 autobusë do të nisën nga Kosova për në Tiranë më 17 tetor, ku edhe pritet të mbahet protesta gjithëkombëtare e Organizatave të Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK). Protesta që do të bëjë thirrje për drejtësi ndaj ish-krerëve të UÇK-së që po mbahen në Hagë, ka marrë mbështetjen e madhe të qytetarëve dhe të institucioneve të Shqipërisë, ka treguar kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, në konferencën për medie. “Ne kemi gjetur mbështetje shumë të madhe nga qytetarë të

Shqipërisë, nga institucionet e shtetit shqiptar dhe nga qeveria. Protesta ka karakter gjithmonë jo kundër gjykatës, jo kundër drejtësisë, por kundër padrejtësisë e cila po ndodh në Hagë tash e pesë vjet”, tha ai. Gucati shtoi se protestës i janë bashkuar edhe PDK-ja dhe AAK-ja. Ndërsa fjalën para protestuesve do ta kenë ish-presidenti shqiptar Alfred Moisiu dhe kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti. “Na kanë mbetur edhe dy ditë deri në protestë. Të premtën do të mbahet protesta. Në Kosovë kanë dalë në mbështetje

shumica e partive politike, PDK, AAK dhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. Ne kemi mbështetje të madhe nga qytetarët. Sa për fjalime, mund t’ju tregoj do të jenë ish-presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu, Ali Ahmeti do ta marrë fjalën, si dhe unë si organizator i protestës. Do të jetë edhe një familje e dëshmorit nga Shqipëria që ka rënë dëshmor në Kosovë, një familjar i tyre. E kemi të konfirmuar që kryeministri Edi Rama do të marrë pjesë në protestë. Jemi duke pritur sot ose nesër të na lajmërojnë edhe për fjalim. Nuk

besoj që do ta refuzojë fjalimin, por varet nga agjenda e tij. Dje na ka thënë se do të marrë pjesë në protestën e 17 tetorit”, tha Gucati. Ai njoftoi se mbështetje për protestën kanë dhënë edhe grupet e tifozëve në Shqipëri dhe se interesimi i qytetarëve është i madh. “Na kanë dhënë mbështetjen edhe tifozët kuq e zi në Shqipëri. Numri i qytetarëve do të jetë bukur i madh. Vetëm nga Kosova deri më sot i kemi deri 60 autobusë me udhëtarë që kanë konfirmuar pjesëmarrjen”, tha ai.

Gucati theksoi se protesta ka karakter kombëtar dhe do të mbahet në vendin ku u formua UÇK-ja. “Protesta ka karakter kombëtar. UÇK-ja e ka gjenezën mu në Tiranë. Aty është formuar në vitet ’90 dhe ne aty pikërisht po shkojmë ku është formuar UÇK-ja, q t’i tregojmë Gjykatës Speciale që UÇK-ja rrjedh nga populli dhe ne jemi nga populli. Pa mbështetjen e qytetarëve shqiptarë ne sot nuk kishim mundur të vepronim apo ta bënim luftën”, tha ai. Protesta do të mbahet më 17 tetor 2025 në orën 17:00 në Sheshin “Skënderbej”.



FORMOHET GRUPI PUNUES I CILI DO TË MERRET ME KATEGORIZIMIN E RREZIKSHMËRISË NË VENDET E PUNËS BRENDË INSTITUCIONEVE TË SHSKUK-SË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 TETOR - Në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) është mbajtur mbledhja e 76 e Bordit Drejtues. Mbledhjen e hapi kryesuesja Tetore Olloni, e cila, pasi lexoi rendin e ditës, u mundësoi anëtarëve të bordit të propozojnë tema të diskutimit në të ndryshme. Kryesuesja e Bordit, hapi në të ndryshme, diskutimin lidhur me Klinikën Emergjente, punën që bëhet, konsultimet dhe punën e specialistëve dhe specialistëve. Anëtar i Bordit, Dren Boshnjaku, ka kërkuar informata lidhur me funksionalizimin e CT-së së re në Klinikën e Neurologjisë, ku mori përgjigje se kjo do të bëhet shumë shpejt. Përfaqësuesi i spitaleve të përgjithshme hapi diskutimin rreth rrezikshmërisë në punë, e



që informoi se ka nisur ky proces dhe pritet që komisioni ta kryejë punën e vet. Besa Alidemaj, përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë, njoftoi lidhur me aprovimin e dokumentit strategjik, përkatësisht aprovimin e Doracakut për Menaxhim të Cilësisë, i cili do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Anëtarja Vjollca Kadolli-Halili nga kujdesi parësor diskutoi në

shumicën e pikave të propozuara. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, gjatë raportimit informoi për zhvillimet më të fundit në kuadër të institucioneve shëndetësore në ShSKUK. Ai bëri me dije se nga e hëna do të nisë puna në Shërbimin/Laboratorin e Toksikologjisë, ku fillimisht do të analizohen nëntë mostrat. Po ashtu, janë marrë 4 mostrat

për skринingun neonatal, që do të mundësojnë diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve të porsalindur dhe fillimin e skринingut neonatal. Gjatë raportimit të tij, drejtori Azizi njoftoi se nga vizita zyrtare në Luksemburg, të realizuar bashkë me drejtorin e Klinikës së Kardiologjisë, është konfirmuar mbështetja e Qeverisë së Luksemburgut për investime në fushën e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë në Kosovë, që do të zbatohen gjatë katër viteve të ardhshme përmes agjencisë zhvillimore Lux Development. Ai njoftoi se është funksionalizuar depoja e barnave në Spitalin e Pejës, e ndërtuar sipas standardeve moderne, ndërsa projekti i ngjashëm në Spitalin e Mitrovicës ka përfunduar dhe pritet kyçja nga KEDS për furnizim me energji elektrike, pas së cilës objekti do të vihet në funksion.

Drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, theksoi se ka filluar shpërndarja e pajisjeve ndihmëse për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndërsa sipas kërkesës së komisionit përkatës, pritet të angazhohet një kompani e specializuar për realizimin profesional të këtij procesi. Po ashtu, u bë me dije se është formuar një grup punues i përbërë nga ekspertë të mjekësisë së punës nga Gjakova, i cili do ta kryejë vlerësimin dhe kategorizimin e rrezikshmërisë në vendet e punës brenda institucioneve të ShSKUK-së. Në mbledhje u paraqit raporti i punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, raporti i punës së Bordit Drejtues, si dhe raporti i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, që trajton iniciimin dhe zhvillimin e procesit të prokurimit të pajisjeve për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga ShSKUK.

KOSOVA PAS 12 TETORIT: KUR DEMOKRACIA PËRBALLET ME REALITETIN



Shkruan: Nazmi JUSUFI,
anëtar i Komisionit Zgjedhor
në shtetin holandez

Zgjedhjet e 12 tetorit në Kosovë ishin një moment vendimtar për demokracinë dhe institucionet e vendit. Procesi zgjedhor, si në aspektin organizativ ashtu edhe në atë institucional, tregoi përparim të dukshëm krahasuar me ciklet e kaluara. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve arriti ta menaxhojë procesin me përgjegjësi,

pavarësi dhe përkushtim, duke respektuar parimet bazë të ligjit zgjedhor dhe të drejtën e qytetarëve për të votuar lirshëm.

Nga këndvështrimi profesional dhe krahasues me standardet e Bashkimit Evropian, Kosova ka bërë hapa të qëndrueshëm drejt konsolidimit të demokracisë zgjedhore. Megjithatë, mbeten disa mangësi të dukshme që kërkojnë trajtim serioz.

Sfida të transparencës dhe komunikimit publik

Një nga sfidat më të mëdha ishte vonesa në publikimin e rezultateve paraprake, që krijoi paqartësi dhe dyshime në opinionin publik. Në vendet e BE-së, komunikimi

institucional në ditët pas votimit është i koordinuar, i menjëhershëm dhe i bazuar në standarde të qarta të transparencës. Kosova duhet të avancojë në këtë drejtim, duke ndërtuar besim të plotë përmes informimit të hapur dhe të vazhdueshëm.

Pjesëmarrja qytetare dhe kultura e votimit

Edhe pse pjesëmarrja në zgjedhje mbeti në nivel të qëndrueshëm, ajo ende është më e ulët sesa mesatarja evropiane. Kjo tregon nevojën për një strategji të gjerë të edukimit qytetar, që votimi të shihet jo thjesht si detyrim, por si përgjegjësi demokratike. Demokracia e vërtetë fillon me vetëdijen qytetare dhe me

përfshirjen aktive në proceset vendimmarrëse.

Kultura politike dhe konkurrenca e ndershme

Në fushatat zgjedhore, në vend të debatit mbi programet dhe ofertat politike, shpesh dominoi retorika emocionale dhe përplasjet personale. Në shtetet e BE-së, fushatat janë të orientuara drejt argumentit, transparencës financiare dhe përgjegjësisë publike. Për Kosovën, kjo mbetet një fushë që kërkon pjekuri politike dhe transformim kulturor.

Një reflektim për të ardhmen

Rezultatet e zgjedhjeve

pasqyrojnë një shoqëri në lëvizje, me zgjedhës më kritikë dhe me kërkesë më të lartë për llogaridhënie. Kjo është një shenjë pozitive, që dëshmon se demokracia po rritet në cilësi, edhe pse rruga drejt një sistemi zgjedhor plotësisht të besueshëm dhe evropian ende nuk ka përfunduar. Zgjedhjet e 12 tetorit e vendosën Kosovën përballë realitetit të saj demokratik: përparim të dukshëm, por edhe nevojë për reflektim të thellë.

Demokracia nuk matet vetëm me numrin e votave, por me mënyrën se si institucionet i mbrojnë, i numërojnë dhe i respektojnë ato. Dhe në këtë drejtim, Kosova ka bërë përparim – por ende ka rrugë për të ecur.

BE-ja PRET CERTIFIKIM TË SHPEJTË TË REZULTATEVE DHE TRANZICION TË RREGULLT TË PUSHTETIT

PRISHTINË, 14 TETOR - Bashkimi Evropian ka mirëpritur procesin zgjedhor paqësor në Kosovë dhe është shprehur e kënaqur që në raundin e parë të zgjedhjeve lokale më 12 tetor pati pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve. “Për ato komuna ku kryetarët janë zgjedhur në raundin e parë, ne bëjmë thirrje për një certifikim të shpejtë dhe zbatim të rezultateve të zgjedhjeve përmes një tranzicioni të rregullt të pushtetit lokal”, tha për Radion Evropa e Lirë zëdhënësja e BE-së, Anitta Hipper. “Për komunat e tjera, ku do të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune, bëjmë thirrje për një proces po aq paqësor, konkurrues dhe gjithëpërfshirës më 9 nëntor”, shtoi ajo.

Nga BE-ja theksojnë se aktualisht në Kosovë ndodhet misioni i tyre i ekspertëve, me ftesë të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmanit. Ky ekip po vëzhgon procesin zgjedhor dhe, në fund, do të japë vlerësimin për të gjithë



procesin. “Raporti i Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) në Kosovë, i majit 2025, theksoi disa raste të ndërhyrjeve gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në shkurt të vitit 2025. Ne presim që të gjitha palët të përmbahen nga veprime të tilla gjatë

periudhës zgjedhore”, theksoi Hipper. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, e kanë akuzuar Serbinë për ndërhyrje në procesin zgjedhor në Kosovë, duke “blerë” komunitetin serb që të votojë

për Listën Serbe, dhe kanë kërkuar reagim nga Bashkimi Evropian. BE-ja nuk ka dhënë një përgjigje konkrete në pyetjen e Radios Evropa e Lirë nëse ka njohuri për ndërhyrje të Serbisë në procesin zgjedhor në Kosovë. Megjithatë, misioni vëzhgues i BE-së për

zgjedhjet parlamentare të shkurtit kishte konstatuar se mediet shtetërore ruse RT Balkan dhe Sputnik Srbija - të mbështetura nga Kremli - kishin publikuar dhjetëra materiale për zgjedhjet në Kosovë gjatë fushatës zgjedhore, me “përmbajtje manipuluese” të drejtuara ndaj komunitetit serb. Në zgjedhjet e 12 tetorit kanë votuar 39.58 për qind e mbi dy milionë qytetarëve me të drejtë vote. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet lokale të së dielës në 21 komuna është zgjedhur kryetari në raundin e parë, ndërsa në 17 komuna të tjera, përfshirë Prishtinën, do të mbahet edhe raundi i dytë. Praktikat e mëparshme kanë treguar se fitorja në raundin e parë nuk garanton fitoren përfundimtare edhe në raundin e dytë në rastet kur ka balotazh. Nga komunat me shumicë serbe, vetëm në Kllokot do të ketë raund të dytë, ndërsa në nëntë të tjerat ka fituar Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila ka mbështetjen e Beogradit.

Musliu: Ka rënie të theksuar të mbështetjes për Listën Serbe në zgjedhjet e fundit lokale

PRISHTINË, 14 TETOR - Themeluesi i institutit “Octopus”, njohës i çështjeve të sigurt, Agim Musliu, ka thënë sot se ka rënie të legjitimitetit të Listës Serbe në Kosovë. Musliu në “Facebook” ka shkruar se që nga detyrimi i serbëve lokalë për t’i zbatuar urdhrat e Beogradit për t’i braktisur institucionet e Kosovës e deri te frikësimi e shantazhimi i tyre, Lista Serbe

e ka humbur legjitimitetin për ta përfaqësuar komunitetin pakicë serb në Kosovë. “Rënia e legjitimitetit të Listës Serbe në Kosovë. Ka një rënie të theksuar të mbështetjes për Listën Serbe në zgjedhjet e fundit lokale dhe kjo shprehet më së miri nga të dhënat e tabelës më poshtë. Si instrument i Beogradit për të instrumentalizuar pakicën serbe në Kosovë, Lista Serbe ka

bërë gjithçka për të përkeqësuar jetën e komunitetit që ajo gjoja përfaqëson. Që nga detyrimi i serbëve lokalë për të zbatuar urdhrat e Beogradit për të braktisur institucionet e Kosovës e deri te frikësimi e shantazhimi i tyre, Lista Serbe e ka humbur legjitimitetin për të përfaqësuar komunitetin pakicë serb në Kosovë”, ka shkruar Musliu.



TRE EKONOMISTË FITOJNË NOBELIN MBI NDIKIMIN E TEKNOLOGJISË NË RITJEN EKONOMIKE

STOKHOLM, 14 TETOR - Çmimin Nobel për Ekonomi sivjet e kanë fituar amerikan-izraeliti Joel Mokyr, Philippe Aghion nga Franca dhe Peter Howitt nga Kanada për punën e tyre mbi ndikimin e teknologjisë në rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Mokyr, 79 vjeç, fitoi gjysmën e çmimit për “identifikimin e parakushteve për rritje të qëndrueshme përmes përparimit teknologjik”, tha Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave.

Aghion, 69 vjeç dhe Howitt, 79 vjeç, ndan gjysmën tjetër të çmimit për “teorinë e rritjes së qëndrueshme përmes shkatërrimit krijues”, shtoi Akademia.

John Hassler, kryetar i komitetit që ndan çmimin, u tha gazetarëve se puna e tyre u është përgjigjur pyetjeve se si shpikjet teknologjike nxisin rritjen dhe si mund të mbahet rritja e qëndrueshme. “Gjatë pothuajse gjithë historisë së njerëzimit, standardet e jetesës nuk ndryshonin shumë nga një brez te brezi tjetër. Rritja ekonomike ishte, mesatarisht, zero dhe stagnimi ishte normë”, tha Hassler.

Por, gjatë dy shekujve të fundit “gjërat kanë ndryshuar shumë”.



“Gjatë 200 vjetëve të fundit bota ka përjetuar më shumë rritje ekonomike se kurrë më parë në historinë e njerëzimit”, shpjegoi për gazetarët Kerstin Enflo, anëtare e Komitetit për çmimin për ekonomi.

Megjithatë, ajo tha se “200 vjet janë ende një periudhë e shkurtër krahasuar me historinë e gjatë të stagnimit që kemi parë më herët”. “Puna e laureatëve na kujton se ne nuk duhet ta marrim përparimin si të mirëqenë. Përkundrazi, shoqëria duhet t'i

mbajë sytë te faktorët që gjenerojnë dhe mbajnë rritjen e qëndrueshme ekonomike”, tha Enflo.

Mokyr, që është profesor në Universitetin Northwestern në Shtetet e Bashkuara, “ka përdorur burime historike si mjet për t'i zbuluar shkaqet e shndërrimit të rritjes së qëndrueshme në normalitet të ri”, tha juria përmes një deklarate.

Ai u spikati sepse demonstroi se nëse “inovacionet do të pasojnë njëra-tjetrën në një proces

vetëgjenerues, nuk mjafton vetëm të dimë se diçka funksionon, por duhet të kemi shpjegime shkencore se pse funksionon”.

Aghion dhe Howitt më pas krijuan një model matematikor për “shkatërrimin krijues” - që i referohet një procesi kur “një produkt i ri dhe më i mirë hyn në treg, kompanitë që shesin produkte të vjetra humbasin”. “S’mund të gjej fjalë që të përshkruaj se si ndihem”, tha Aghion për gazetarët përmes

telefonit pasi u bë publik lajmi për çmimin.

Çmimi për Ekonomi është i vetmi që nuk është pjesë e pesë çmimeve origjinale të krijuara në bazë të testamentit të shkencëtarit suedez Afred Nobel i cili vdiq më 1896.

Ky çmim u krijua më 1968 përmes një donacioni nga Banka Qendrore suedeze. Por, edhe sikurse çmimet për Kimi dhe Fizikë, Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave zgjedh fituesit dhe ndjek të njëjtin proces për përzgjedhje.

Çmimi në ekonomi mbyll ndarjen e çmimeve të Nobelit për këtë vit, kur u nderuan shkencëtarët për punën e tyre për sistemin imunitar të njeriut, për aplikimet praktike të mekanikës kuantike dhe zhvillimin e formave të reja të arkitekturës molekulare.

Nobeli për Letërsi iu dha shkrimtarit hungarez Laszlo Krasznahorkai, veprat e të cilit eksplorojnë temat e distopisë post-moderne dhe melankolisë. Udhëheqësja e opozitës venezueliane, Maria Corina Machado, mori Çmimin Nobel për Paqe.

Fituesit e Çmimit Nobel për Ekonomi marrin një diplomë, një medalje prej ari dhe një çek prej 1.2 milion dollarësh.

TARIFAT E TRUMPIT PËR DRURIN DHE MOBILIET HYJNË NË FUQI, RREZIKOHEN EDHE TREGTARËT E KOSOVËS

PRISHTINË, 14 TETOR - Tarifat e reja të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, mbi drurin e importuar, mobiliat dhe dollapët e kuzhinës, kanë hyrë në fuqi të martën. Masat më të fundit përfshijnë një tarifë prej 10-përqindësh mbi importet e drurit të butë, ndërsa detyrimet mbi disa mobilie të mbështjella dhe dollapë kuzhine nisin nga 25 për qind.

Mobiliat, dyert dhe dritaret, materialet ndërtimore prej druri janë ndër eksportet kryesore të Kosovës në ShBA në vitet e fundit.

Nga 1 janari norma për mobiliat e mbështjella të importuara pritet të ngrihet në 30 për qind, ndërsa ato për dollapët e kuzhinës në 50 për qind. Megjithatë, detyrimet për produktet prej druri nga Britania nuk do të kalojnë 10 për qind, ndërsa ato nga Bashkimi Evropian dhe Japonia do të përballen me një tavan prej 15-përqindësh.

Të tre partnerët tregtarë kanë arritur marrëveshje me administratën Trump për të shmangur tarifa më të ashpra. Ende nuk është e qartë se çfarë tarifa do të vlejnë për Kosovën, që tashmë ka hequr tarifën doganore prej 10-përqindësh ndaj të gjitha produkteve të importuara nga ShBA-ja.

Arieta Vula nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës thotë se shpreson që



institucionet e Kosovës do të reagojnë sa më shpejt për ta njoftuar sektorin se si do të preken ata dhe të tentojnë të arrijnë marrëveshje me ShBA-në që tarifën sa më të ulët të vlejnë për Kosovën. “Ne kemi eksport nga ana e ndërmarrjeve të drurit drejt Evropës dhe ShBA-së, mirëpo për ShBA-në duhet të sqarohen këto dilema dhe pikëpyetje sepse kjo mund ta vështirësojë eksportin drejt ShBA-së”, thotë Vula për “Radion Evropa e Lirë”.

Ajo shton se, edhe pse eksporti në ShBA nuk është shumë i madh, ai ka filluar të rritet dhe tarifën do ta bënin eksportin të paleverdishëm në disa mënyra.

“Prodhuarit do ta zvogëlonin eksportin sepse fillon e zvogëlohet kërkesa për të marrë produkte nga Kosova prej ShBA-së. Në momentin kur atyre u rritet tarifa, ata kërkojnë në tregjet ku e kanë tarifën më të vogël”, shton ajo. Megjithatë, ajo sqaron se një tarifë potenciale nuk do ta ndikonte çmimin e këtyre produkteve për konsumatorët e Kosovës.

Sipas Shtëpisë së Bardhë, detyrimet doganore u vendosën për ta forcuar industrinë amerikane dhe për ta mbrojtur sigurinë kombëtare. Ato bëhen pjesë e një sërë tarifash të veçanta sektoriale që Trumpi ka vendosur që prej rikthimit të tij

në presidencën amerikane. Por, tarifën e reja do të “krijojnë pengesa shtesë për një treg banesash tashmë të vështirë, duke rritur më tej kostot e ndërtimit dhe rinovimit”, paralajmëroi kryetari i Shoqatës Kombëtare të Ndërtuesve të Shtëpive (NAHB), Buddy Hughes. Duke vendosur tarifën e fundit, Trumpi tha se sekretari i Tregtisë kishte zbuluar se “produktet e drurit përdoren në funksione kritike të Departamentit të Luftës, përfshirë ndërtimin e infrastrukturës për teste operative”.

Deklarata e Trumpit shtoi se prodhimi amerikan i drurit “mbetet i pazhvilluar”, duke e lënë

vendin të varur nga importet. Por, Hughes nga NAHB-ja tha se “vendosja e këtyre tarifave nën pretekstin e ‘sigurisë kombëtare’ injoron rëndësinë që ka banimi për sigurinë fizike dhe ekonomike të të gjithë amerikanëve”.

Ai bëri thirrje për një marrëveshje që “t'i zhbëjë tarifën mbi materialet e ndërtimit”.

Edhe Kanada, furnizuesja kryesore e drurit për Shtetet e Bashkuara, pritet të preket. Tarifa 10 për qind mbi drurin shtohet mbi detyrimet aktuale që ShBA-ja ia ka rritur së fundi në 35 për qind. Kjo do të thotë se veprimi më i fundit i Trumpit e çon tarifën e përgjithshme për drurin kanadez në 45 për qind.

Stephen Brown nga Capital Economics i tha AFP-së se me 30 për qind të drurit që buron nga jashtë, një tarifë 10 për qind mund ta rrisë koston e ndërtimit të një shtëpie mesatare për 2 200 dollarë.

Brown shtoi se Kina, Vietnam dhe Meksika përbëjnë pjesën më të madhe të importeve amerikane të mobilieve. Ai pret që Vietnam të përballët me ndikimin më të madh “pasi mobiliat përbëjnë 10 për qind të eksporteve të tij drejt ShBA-së”.

Tarifat u vendosën në bazë të Nenit 232 të Aktit për Zgjerimin e Tregtisë të vitit 1962, e njëjta dispozitë që Trumpi përdori për t'i vendosur tarifën mbi çelikut, aluminin dhe automjetet këtë vit.

“TË LIDHUR ME ZINXHIRË, TË TORTURUAR DHE TË URITUR” - PENGJET IZRAELITE RRËFEJNË TMERRIN QË PËRJETUAN NGA HAMASI

Pas më shumë se dy vjetësh robërie, 20 pengjet e fundit që Hamasi mbante në tunelet e Gazës u liruan dje, duke shënuar një kthesë historike në konfliktin dhe një moment të rrallë shprese për paqen në Lindjen e Mesme.

Lirimi u bë pas nënshkrimit të marrëveshjes së re të armëpushimit, e cila u garantua nga Shtetet e Bashkuara. Rrëfimet e para të pengjeve kanë zbuluar përmasat e tmerrit që kanë përjetuar gjatë 24 muajve të fundit.

Të mbajtur në errësirë totale, të izoluar nga bota dhe shpesh pa ushqim për ditë të tëra, shumë prej tyre treguan se ishin afruar në kufijtë e mbijetesës. Disa thanë se rojet e Hamasit hanin para syve të tyre, ndërsa ata vetë ishin të uritur deri në ekstrem.

Njëri prej tyre, Avinatan Or, 32 vjeç, i rrëmbyer nga Festivali i Nova-s bashkë me të dashurën e tij Noa Argamani, u mbajt në izolim pothuajse për dy vjet. Ai humbi gati 40 për qind të peshës trupore dhe nuk kishte asnjë informacion për botën jashtë.

Binjakët Gali dhe Ziv Berman, 28 vjeç, që gjithashtu u rrëmbyen gjatë masakrës së 7 tetorit, u mbajtën të ndarë për gjithë kohën e robërisë. Ata nuk e dinin nëse tjetri ishte gjallë, derisa u përqaftuan për herë të parë ku të dy ishin në gjendje të dobët fizike, por me moral të

lartë, sipas familjarëve.

Një tjetër peng, ushtari 22-vjeçar Matan Angrest, përjetoi tortura të rënda gjatë muajve të parë. Nëna e tij, Anat, tregoi për mediat lokale se i biri ishte rrahur aq keq sa kishte humbur ndjenjat dhe ishte tërhequr zvarrë me thasë të zinj në kokë. “Ata e mashtronin, i thoshin se Izraeli e kishte harruar, se Hamasi do të fitonte. Ishte një luftë e rëndë psikologjike”, rrëfeu ajo.

Guy Gilboa-Dalal, një tjetër i mbijetuar nga Festivali i Nova-s, tha se ishte ushqyer me forcë pasi rrëmbyesit e tij kishin frikë nga reagimet ndërkombëtare pas publikimit të një videoje ku një tjetër peng, Evyatar David, shihej në gjendje të rëndë duke hapur varrin e vet. Sipas prindërve të Davidit, ai dhe të tjerët u përdorën si mburoja njerëzore nga Hamasi për t’i shpëtuar bombardimeve izraelite.

Disa pengje, si Omri Miran, u zhvendosën dhjetëra herë gjatë robërisë. Ai u detyrua të gatonte për rrëmbyesit e tij, ndërsa përpiquej të ruante shpresën dhe të numëronte ditët.

“Ai e dinte saktësisht sa ditë kishte kaluar në robëri”, tregoi vëllai i tij, Nadav.

Ndërsa rrëfimet e tyre trondisin opinionin publik, lirimi i pengjeve u bë pjesë e një



marrëveshjeje të gjerë paqeje që synon t’i japë fund luftës në Gaza. Si pjesë e saj, Izraeli liroi 1,968 të burgosur palestinezë nga burgjet e tij, ndërsa Hamasi dorëzoi 20 pengjet e fundit që mbante.

Presidenti amerikan Donald Trump, i cili mori pjesë personalisht në nënshkrimin e deklaratës së paqes në Sharm el-Sheikh, e cilësoi ditën si të jashtëzakonshme për botën dhe për Lindjen e Mesme.

“Pas shumë vitesh dhimbjeje,

më në fund kemi paqe”, tha ai, ndërsa lavdëroi kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu për vendosmërinë e tij.

Dokumenti i nënshkruar nga udhëheqësit e Egjiptit, Katarit dhe Turqisë përfshin angazhimin për rindërtimin e Gazës dhe garancinë e ndalimit të luftimeve, megjithëse nuk përmend drejtpërdrejt një zgjidhje me një apo dy shtete. Presidenti egjiptian Abdel Fattah al-Sisi deklaroi se marrëveshja mbyll një kapitull

të dhimbshëm në historinë njerëzore dhe krijon terrenin për një zgjidhje të qëndrueshme politike.

Lirimi i pengjeve shënon fundin e një periudhe të errët për dhjetëra familje izraelite dhe një fillim të ri për përpjekjet diplomatike në rajon. Megjithatë, plagët fizike e psikologjike që mbartin të mbijetuarit dëshmojnë për një dhunë të papërshkrueshme që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në të dy anët e konfliktit.

ZELENSKY U BËN THIRRJE LIDERËVE BOTËRORË: MOS E HUMBNI VRULLIN PËR PAQEN, JEPINI FUND LUFTËS NË EVROPË

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, u ka bërë thirrje liderëve botërorë që të mos e humbasin vrullin për avancimin e paqes, duke e lidhur këtë me përparimin e fundit në Lindjen e Mesme, pas marrëveshjes së armëpushimit në Gaza.

“Lufta në Evropë gjithashtu mund të marrë fund”, deklaroi Zelenskyy, duke theksuar se roli dhe lidhshëpi i Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve ndërkombëtarë janë vendimtarë për t’i dhënë fund agresionit rus ndaj Ukrainës.

Në një postim në platformën X, presidenti ukrainas bëri të ditur se kishte zhvilluar një bisedë afro njëorëshe me presidentin finlandez, Alexander Stubb, gjatë së cilës u diskutua koordinimi i qëndrimeve për paqen dhe forcimin e mbrojtjes ajrore të Ukrainës.

Keep Watching
Recently Spotted Asteroid Set for Near Miss With Earth

00:00/01:31

“Tani, ndërsa lufta në Lindjen e Mesme po mbaron, është e

rëndësishme të mos humbasim vrullin për të çuar përpara paqen. Lufta në Evropë gjithashtu mund të marrë fund, dhe për këtë, lidhshëpi si i Shteteve të Bashkuara ashtu edhe i partnerëve të tjerë është me rëndësi të madhe”, shkroi Zelenskyy.

Ai gjithashtu përgëzoi presidentin amerikan Donald Trump për përpjekjet e tij për të siguruar lirimin e pengjeve dhe për ndalimin e luftës në Gaza, duke shtuar se veprimet e duhura nga SHBA-të mund të ndihmojnë gjithashtu në përfundimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës. Zelenskyy shtoi se me presidentin finlandez diskutuan edhe sulmet e fundit ruse ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës dhe nevojën për të forcuar sistemin e mbrojtjes ajrore.

Ai falënderoi Finlandën për gatishmërinë për të ndihmuar, duke nënvizuar se “Rusisë duhet t’i hiqen mjetet për të vazhduar luftën dhe terrorin e saj, kjo mund të jetë baza më e besueshme për paqen në rajonin tonë”.



ZBARDHET TEKSTI I MARRËVESHJES SË PAQES MES IZRAELIT DHE PALESTINËS



Ky është versioni i plotë i marrëveshjes për paqe në Rripin e Gazës, e nënshkruar më 13 tetor 2025 nga Presidenti Donald Trump, Presidenti i Egjiptit Abdel Fattah al-Sisi, Emir i Katarit Tamim bin Hamad Al-Thani dhe Presidenti i Turqisë Recep Tayyip Erdogan...

TEKSTI I PLOTË:

Ne, të nënshkruarit, mirëpresim angazhimin dhe zbatimin vërtet historik nga të gjitha palët, të Marrëveshjes së Paqes së Trump, e cila i jep fund më shumë se dy viteve vuajtjesh dhe humbjes të thella, duke hapur një kapitull të ri për rajonin, të shënuar nga shpresa, siguria dhe një vizion i përbashkët për paqe dhe prosperitet. Ne mbështesim dhe miratojmë përpjekjet e singerta të Presidentit Trump për t'i dhënë fund luftës në Gaza dhe për të sjellë paqe të

qëndrueshme në Lindjen e Mesme. Së bashku, ne do ta zbatojmë këtë marrëveshje në një mënyrë që siguron paqe, siguri, stabilitet dhe mundësi për të gjithë popujt në rajon, përfshirë palestinezët dhe izraelitët. Ne e pranojmë se një paqe e qëndrueshme do të jetë ajo në të cilën si palestinezët ashtu edhe izraelitët mund të lulëzojnë, me të drejtat e tyre themelore të njeriut të mbrojtura, sigurinë e tyre të garantuar dhe dinjitetin e tyre të mbrojtur. Ne pohojmë se përparimi kuptimplotë realizohet përmes bashkëpunimit dhe dialogut të qëndrueshëm, dhe se forcimi i lidhjeve midis kombeve dhe popujve i shërben interesave të qëndrueshme të paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global. Ne e njohim rëndësinë e thellë historike dhe shpirtërore të këtij rajoni për komunitetet fetare, rrënjët e të cilave janë të ndërthurura me tokën, duke përfshirë Krishtërimin, Islamin

dhe Judaizmin. Respekti për këto lidhje të shenjta dhe mbrojtja e vendeve të tyre të trashëgimisë do të mbeten në themel të angazhimit tonë për bashkëjetesë paqësore. Ne jemi të bashkuar në vendosmërinë tonë për të çmontuar ekstremizmin dhe radikalizimin në të gjitha format e tyre. Asnjë shoqëri nuk mund të lulëzojë kur dhuna dhe racizmi normalizohen, ose kur ideologjitë radikale kërcënojnë strukturën e jetës civile. Ne jemi të përkushtuar për t'i bërë ballë situatave që nxisin ekstremizmin dhe për të promovuar arsimin, mundësitë dhe respektin e ndërsjellë si themele për paqe të qëndrueshme. Prandaj, ne angazhohemi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ardhshme përmes angazhimit diplomatik dhe negociatave, në vend të forcës ose konfliktit të zgjatur. Ne e pranojmë se Lindja e

Mesme nuk mund të tolerojë një cikël të vazhdueshëm luftërash të zgjatura, negociatash të bllokuara ose zbatimin e pjesshëm, të paplotë ose selektiv të kushteve të negociuara me sukses. Tragjeditë që kemi parë gjatë dy viteve të fundit duhet të shërbejnë si një kujtesë urgjente se brezat e ardhshëm meritojnë më shumë sesa dështimet e së kaluarës. Ne kërkojmë tolerancë, dinjitet dhe mundësi të barabarta për çdo person, duke siguruar që ky rajon të jetë një vend ku të gjithë mund të ndjekin aspiratat e tyre në paqe, siguri dhe prosperitet ekonomik, pavarësisht nga raca, besimi ose etnia. Ne ndjekim një vizion gjithëpërfshirës të paqes, sigurisë dhe prosperitetit të përbashkët në rajon, të bazuar në parimet e respektit të ndërsjellë dhe fatit të përbashkët. Në këtë frymë, ne mirëpresim progresin e bërë në arritjen e



marrëveshjeve gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të paqes në Rripin e Gazës, si dhe marrëdhëniet miqësore dhe reciprokisht të dobishme midis Izraelit dhe fqinjëve të tij rajonalë. Ne angazhohemi të punojmë së bashku për të zbatuar dhe mbështetur këtë trashëgimi, duke ndërtuar themele institucionale mbi të cilat brezat e ardhshëm mund të lulëzojnë së bashku në paqe. Ne jemi të përkushtuar për një të ardhme me paqe të qëndrueshme.

Donald J. Trump, President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Abdel Fattah al-Sisi, President i Republikës Arabe të Egjiptit

Tamim bin Hamad Al-Thani, Emir i Shtetit të Katarit

Recep Tayyip Erdogan, President i Republikës së Turqisë



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Krasniqi dhe Baruti i bashkohen Prishtinës

Prishtinë, 14 tetor - FC Prishtina e ka afruar në radhët e veta Elton Krasniqin, sulmues anësor 20-vjeçar, i cili i bashkohet skuadrës nga kryeqyteti me një përvojë nga futbollit gjerman. Krasniqi ka qenë pjesë e Stuttgartit, ku ka luajtur për ekipin U19 dhe

skuadrën e dytë të klubit. Më herët ai ka qenë edhe pjesë e gjeneratave të reja të Hannoverit. Në arenën ndërkombëtare Eltoni ka përfaqësuar Kombëtaren e Kosovës në grupmoshat U15, U17 dhe U19. Përfaqen zyrtare të klubit, Krasniqi ka

deklaruar: “Jam i lumtur që jam pjesë e një klubi të madh siç është Prishtina. Shpresoj që do të jetë një vit i mbarë dhe do ta jap maksimumin për objektivat tona. Menxi pres të luaj para tifozëve tanë ‘Plisat’”. Po ashtu, Prishtinës i është bashkuar edhe Shkambi

Baruti. Baruti vjen me një përvojë nga futbollit shqiptar. Ai ishte pjesë e Partizanit, më pas ka kaluar te Tomori, ndërsa së fundmi ka luajtur për ekipin e Erzenit. 21-vjeçari përfaqen zyrtare të klubit është shprehur i lumtur që është bërë pjesë e Prishtinës.



KOSOVA SHËNON FITORE HISTORIKE NË SUEDI

Goteborg, 14 tetor - Kombëtarja e Kosovës ka regjistruar një ndër fitoret më të mëdha në historinë e saj, duke triumfuar me rezultat 1:0 ndaj Suedisë në “Ullevi” të Goteborgut. Në një atmosferë të jashtëzakonshme, përball mijëra tifozëve “Dardanë”, djemtë e përzgjedhës Franco Foda kanë zhvilluar një ndeshje të shkëlqyer, duke treguar karakter, guxim dhe përkushtim të madh. Golin e fitores së madhe e ka realizuar Fisnik Asllani në minutën e 32-të, pas një aksioni të bukur që nisi nga Vedat Muriqi dhe Veldin Hoxha. Gëzimi në tribuna dhe në fushë ishte i papërshkrueshëm, ndërsa përkrahja e tifozëve shqiptarë në Suedi ishte e jashtëzakonshme gjatë gjithë ndeshjes. Kosova ka pasur rast të artë për ta dyfishuar epërsinë në minutën e 43-të, por goditja e

fuqishme e Muriqit është ndalur nga portieri vendës, ndërsa ajo e Leon Avdullahut është ndalur nga shtylla. Në pjesën e dytë Suedia ka ushtruar presion të madh, por Kosova ka treguar qëndrueshmëri të jashtëzakonshme në mbrojtje. Portieri Aro Muriq është shquar me disa pritje vendimtare, ndërsa linja mbrojtëse me Albion Hajdarin e Dion Gallapenin në krye ka treguar organizim të mirë. Me këtë fitore të madhe Kosova forcohet në pozitën e dytë të Grupit B me 7 pikë pas katër ndeshjeve, duke u afruar edhe më shumë drejt ëndrrës së madhe, kualifikimit në Kupën e Botës 2026. Përzgjedhësi Franco Foda është shprehur i lumtur dhe krenar për ekipin. “Jam shumë krenar për këtë skuadër, për këta futbollistë dhe për mënyrën se si luftuan në fushë. Ishte një



paraqitje e shkëlqyer dhe një fitore e merituar për Kosovën”, ka thënë Foda pas ndeshjes. Edhe presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka përgëzuar djelmoshat dardanë për fitoren ndaj Suedisë. “Goli i Fisnik

Asllanit në stadiumin ‘Ullevi’ na dha emocione të papërshkrueshme, ndërsa angazhimi deri në atomin e fundit i secilit futbollist për ta mbrojtur epërsinë ishte i pashoq. Urime Kosova ime për këtë fitore të madhe!

Vazhdojmë me përkushtim dhe besim drejt ëndrrës së madhe, kualifikimit në Kupën e Botës 2026. Falënderim nga zemra për secilin futbollist, përzgjedhësin Franco Foda dhe stafin e tij për punën e shkëlqyer, si dhe për çdo pjesëtar të stafit të Kombëtares për përkushtimin e treguar në vazhdimësi. Mirënjohje të veçantë për tifo-grupin ‘Dardanë’ dhe bashkatdhetarët tanë nga Suedia, Evropa dhe mbarë bota që ishin sonte në numër të madh përkrah ekipit tonë”, ka thënë Ademi. Për këtë fitore, Kombëtarja e Kosovës është uruar nga presidentja Vjosa Osmani, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, kryeministri shqiptar Edi Rama, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ai i LDK-së, Lumir Abdixhiku, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj etj.

TRESHJA DARDANE PO SHKËLQEN NË HOFFENHEIM: ASLLANIT DHE AVDULLAHUT U RRITET NDJESHËM VLERA

Prishtinë, 14 tetor - Po vazhdon shkëlqimi i futbollistëve të Kosovës nëpër kampionate të ndryshme evropiane dhe një nga shembujt më të mirë është treshja dardane e Hoffenheimit, Fisnik Asllani, Leon Avdullahu dhe Albion Hajdari. Sipas përditësimeve më të fundit të “Transfermarkt”, dy nga këta lojtarë kanë përjetuar një rritje të ndjeshme

të vlerës së tyre në treg. Sulmuesit Fisnik Asllani vlera i është rritur nga 8 milionë në 18 milionë euro falë paraqitjeve të jashtëzakonshme në Bundesliga dhe kontributit të tij në fazën ofensive të skuadrës ku ka shënuar pesë gola dhe ka dhuruar dy asistime në shtatë ndeshje mes kampionatit dhe Kupës së Gjermanisë. 23-vjeçari tani është futbollisti me



vlerën më të madhe te Hoffenheimi. Ndërkohë, Leon

Avdullahu, mesfushori me teknikë të rafinuar dhe energji të pashtershme, ka parë një rritje nga 10 në 12 milionë euro, duke u bërë një nga talentet më premtues të klubit gjerman. Sa i përket Albion Hajdarit, mbrojtësit që i është bashkuar Hoffenheimit së fundmi, vlera e tij mbetet 12 milionë euro, pa ndryshime në këtë përditësim të fundit. Megjithatë,

prithmëritë janë të mëdha që edhe ai të pësojë rritje të shpejtë nëse vazhdon me paraqitje të mira në Bundesliga. Kjo rritje e vlerave tregon se futbollistët e Kosovës po fitojnë gjithnjë e më shumë vëmendje në elitën e futbollit gjerman, ndërsa Hoffenheimi po shndërrohet në një bazë të rëndësishme zhvillimi për talentet nga Kosova.

Ancelotti synon të bëhet selektori i parë i huaj që e fiton Botërorin

BRASILIA, 14 TETOR - Carlo Ancelotti dëshiron të lërë gjurmë edhe në bankinën e Brazilit. Pasi ka siguruar kualifikimin në Botërorin 2026, trajneri italian dëshiron ta shkruajë një faqe historike, nga momenti që asnjë

kombëtare nuk e ka fituar asnjëherë Kupën e Botës me një trajner të huaj. “Ekziston gjithmonë hera e parë. Objektivi imi është ta jap maksimumin për Kombëtaren braziliane, duke u munduar ta bëj ekipin që të luajë sa më

mirë që është e mundur dhe ta fitojë Botërorin”, ka thënë selektori i Brazilit, i cili, nëse triumfon në Botërorin 2026, do të bëhet trajneri i parë që është lindur në një shtet tjetër, por që e fiton me një shtet tjetër trofeun më të rëndësishëm në

futbollin botëror. Brazili e ka fituar Kupën e Botës për herë të fundit në vitin 2022, ndërsa tash synon ta rikthejë lavdinë në Botërorin që do të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada dhe në Meksikë.





INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

Prishtinë, 14.10.2025

Në bazë të neneve 25, 26 dhe 27 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neneve 23, 26 dhe 27 të Statutit të Institutit Albanologjik në Prishtinë, si dhe vendimit të datës 10.10.2025, Këshilli Drejtues i IAP shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës së punës: Drejtor

Institucioni: Instituti Albanologjik – Prishtinë

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik

Data e njoftimit: 14.10.2025

Afati për aplikim: 15.10.2025 - 13.11.2025

Vendi i punës: Prishtinë

Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:

- Të jetë doktor i shkencave albanologjike i njërës nga fushat me të cilat merret Instituti Albanologjik (gjuhësi, letërsi, folklor, histori ose etnologji);
- Të ketë titullin kërkimor shkencor së paku bashkëpunëtor i lartë shkencor / profesor i asocuar;
- Të ketë vepra të botuara shkencore me rëndësi të veçantë në fushën përkatëse;
- Të ketë njohuri të dëshmuara për problematikën e studimeve albanologjike;
- Të ketë përvojë në udhëheqjen e institucioneve shkencore dhe të punëve kërkimore shkencore;
- Kandidati, me rastin e konkurrencës duhet ta paraqesë projektin katër (4) vjeçar për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore si dhe të mbarëvajtjes së punëve të tjera në Institut;
- Preferohet që kandidati të njohë gjuhën angleze ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj të rëndësishme, si dhe ndonjë gjuhë tjetër zyrtare të RKS.

Detyrat dhe përgjegjësitë: Drejtori i Institutit Albanologjik – Prishtinë, ka detyrime dhe përgjegjësi të parapara me ligj, me Statut të Institutit të Institutit Albanologjik – Prishtinë:

- Udhëheq dhe e përfaqëson Institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së Institutit;
- Udhëheq veprimtarinë e Institutit dhe ndërmerr masa për realizimin e saj;
- Kryeson Këshillin Drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre;
- Kryeson Këshillin Shkencor;
- Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit;
- Organizon punën dhe veprimtarinë e Institutit;
- Nxjerr aktin për sistematizimin e vendeve të punës sipas propozimit të Këshillit Shkencor;
- Nënshkruan kontratat e punës me punëtorët e Institutit Albanologjik;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e Institutit.

Kohëzgjatja e zgjedhjes: Mandati i drejtorit është katër vjet.

Kandidatët duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi/diploma për nivelin e shkollimit (diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara);
- Dëshmi për përvojë në udhëheqje;
- Dëshmi për përvojën kërkimore-shkencore;
- Projektin për zhvillimin e veprimtarisë së IAP-së për periudhën 4-vjeçare;
- Vërtetim të lëshuar nga organi kompetent që vërteton se ndaj kandidatit nuk është duke u zhvilluar hetim.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATET

Zgjedhja e drejtorit të Institutit Albanologjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e Institutit Albanologjik.

Dokumentet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, kurse dokumentet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët, dokumenteve të tyre duhet t'u bashkëngjisin kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon pozita për të cilën konkurrojnë.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen drejtpërdrejt në Institutin Albanologjik, adresa: Rr. Eqrem Çabej, nr. 93, Prishtinë, 10000, si dhe në adresën elektronike: institutialbanologjik@gmail.com.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni administratën e Institutit Albanologjik, çdo ditë pune në tel: 038 249-867, prej orës 08:00 – 16:00.



ALBANOLOSKOG INSTITUTA - PRIŠTINA

Pristina, 14.10.2025 god

Na osnovu člana 25, 27 i 27 Zakona o naučno istraživačkoj delatnosti, br. 04/L-135 od 28.03.2013 godine, kao i na osnovu člana 26 i 27 Statuta Albanološkog Instituta, kao i odluke od 10.10.2025 godine Upravni savet AIP raspisuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Direktor

Institucija: Albanološki Institut – Priština

Odgovara: Upravnon Savetu Albanološkog Instituta

Datum objave: 14.10.2025

Rok za apliciranje: 15.10.2025 - 13.11.2025

Radno mesto: Priština

Kandidat treba da ispunjava sledeće uslove:

- Da je doktor albanoloških nauka u nekoj od oblasti kojima se bavi Albanološki Institut (jezik, knjizevnost, folklor, historija, ili etnologija);
- Da najmanje ima naučno zvanje Visoki naučni saradnik / asocirani profesor;
- Da ima objavljenin dela sa posebnom važnoscu u doticnom polju istraživanja;
- Da ima dokazana znanja za problematiku albanoloških istraživanja;
- Da ima iskustvo u rukovodjenju naucnih institucija i nauco istraživackih radova;
- Kandidat prilikom konkurisanja mora da prezentuje četvorogodišnji projekat razvoja istraživačkonaučnog rada kao i tok ostalih radova u Institutu;
- Poželjno je da kandidat zna engleski jezik, ili neki drugi važan strani jezik, kao i neki drugi službeni jezik RKS.

Dužnosti i odgovornosti: Direktor Albanološkog Instituta - Priština, ima obaveze i odgovornosti određene zakonom i sa Statutom Albanološkog Instituta - Priština:

- Rukovodi i predstavlja Institut i odgovoran je o zakonitosti delovanja instituta;
- Rukovodi i organizuje rad i delovanje institute i preduzima mere za njegovu realizaciju;
- Upravlja Upravnog odborom, i stara se o sprovođenju njihovih odluka;
- Upravlja naučnim savetom;
- Naredjuje i odgovoran je za sprovođenje finansijskog plana Instituta;
- Organizuje rad i delatnost Instituta;
- Donosi akt za sistematizaciju radnih mesta prema predlogu naučnog saveta;
- Potpisuje radne ugovore sa radnicima Albanološkog Instituta;
- Vrši i druge radnje utvrdenezakonom i Statutom instituta.

Trajanje izbora: Direktor se bira na period od četiri (4) godine.

Kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zahtev;
- Biografija (CV);
- Izvod iz registra rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokaz/diplome o stepenu obrazovanja (diplome stečene u inostranstvu moraju biti overene kod notara);
- Dokaz o rukovodecem iskustvu;
- Dokaz o istraživačko-naučnom iskustvu;
- Projekat razvoja delatnosti AIP za period od 4 godine;
- Uverenje izdata od strane nadležnig organa kojim se dokazuje da se protiv kandidata ne vodi istraga.

Opšti podaci za kandidate:

Direktor Albanološkog Instituta bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 za naucno istrazivacku delatnost i Statutu Albanološkog Instituta

Prijave poslate poštom, na kojima se nalazi poštanski žig na dostavi izvršenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i razmatraće se ukoliko stignu u roku od 4 dana, dok prijave koje stignu nakon ovog roka i one nepotpune neće biti uopšte razmatrane

Kandidati su dužni da uz svoja dokumenta prilože kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i drugu neophodnu dokumentaciju koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Popunjena dokumenta predaju se Albanološkom Institutu, adresa: Ul. Eqrem Çabej, br. 93, Pristina, kao i u **e-mailu: institutialbanologjik@gmail.com**.

Detaljne informacije mozete dobiti u administraciju Albanološkog Instituta svakog radnog dana u tel: 038 249-867, prej orës 08:00 – 16:00.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Le Kosovo Renewable Energy” J.S.C. Prishtinë , në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaike 9.8MWp, në Z.K. Lutogllavë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.12.2025 në ora 11:00 në Objektin e ShFMU “Bajram Kuqi 101” Lutogllavë, Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Le Kosovo Renewable Energy” J.S.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM <https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>
Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Le Kosovo Renewable Energy” J.S.C. Prishtinë , për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun e Energjisë Solare Fotovoltaike 9.8MWp, në Z.K. Lutogllavë, Pejë. <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “HEP Energjia” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810818487 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “HEP Energjia” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810818487 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “HEP Energjia” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810818487 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Sylë A. Shala” B.I. Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin e Therjes së Gjedheve në Z.K. Zallç, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.12.2025 në ora 09:00 në Objektin e “Shtëpisë së Kulturës”, rr. “Skënderbeu” Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Sylë A. Shala” B.I. Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM <https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>
Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Sylë A. Shala” B.I. Istog, për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin e Therjes së Gjedheve në Z.K. Zallç, Istog. <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

